



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 670/7 Prot

Tiranë, më 26.11.2020

V E N D I M

Nr.162, datë 26.11.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të lirimimit nga detyra dhe kalimit në listën e pritjes pa pagesë, të anëtarit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues, **.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur prej nëpunësit, *****,

Vërej se:

Nëpunësi ***** , nëpërmjet një kërkesë protokolluar me nr. 670 prot., datë 28.08.2020 (shoqëruar disa herë me shtesa dokumentacioni të ardhura dhe të rregjistruara përkatësisht me nr. 670/1 prot., datë 15.09.2020, nr. 670/3 prot., datë 23.09.2020, nr. 670/4 prot., datë 05.10.2020 dhe nr. 670/5 prot., datë 08.10.2020), ka ngritur disa pretendime për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit të ristrukturimit të Kryeministritë (viti 2018), proces i cili është shoqëruar me lirimimin nga detyra të nëpunësit në fjalë si Drejtor i Njësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, duke e kaluar atë në listën e pritjes pa pagesë, të anëtarëve të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 670/2 prot., datë 21.09.2020, i janë kërkuar Departamentit të Administratës Publike (DAP) gjithë materialet dokumentare që pasqyrojnë veprimet administrative të kryera në lidhje me sa më sipër, materiale të cilat u dërguan nga ky i fundit me shkresën nr. 4326/1 prot., datë 06.10.2020 “Kthim përgjigje tuajës nr. 670/2 prot., datë 21.09.2020”.

Në aktet e dërguara dhe të analizuara nga Komisioneri, rezulton e vërtetuar se, nëpunësi ***** është anëtar i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues, që prej datës 11.02.2016, kur është emëruar në pozicionin “Drejtor i Njesisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit”, në Kryeministri, sipas përcaktimeve të nenit 30, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 1-4, Kreu VII, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

Ndërkohë, në mbështetje të procedurës së parashikuar në aktin e mësipërm nënligjor (pika 5 Kreu VII, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave) ai, është liruar nga pozicioni i rregullt, me shkresën nr. 7052/1 prot., datë 05.10.2018 të Departamenti të Administratës Publike, pas kërkesës së regjistruar me nr. 3973 prot., datë 30.08.2020 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “Kërkesë për lirim të ***** nga një pozicion i rregullt i nivelit të lartë drejtues”.

Në shkresën e tij DAP, në rolin e njesisë përgjegjëse, sqaron se, pas lirit të tij nga detyra, nëpërmjet të njëjtit akt, nëpunësi ***** , është regjistruar në listën e anëtarëve të TND-së në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt të nivelit të lartë drejtues. Konstatohet se deri në momentin aktual, ai ka mbetur në pritje, pasi pranë Njesisë Përgjegjëse nuk është administruar asnjë kërkesë për emërimin e tij.

Gjithashtu edhe DAP, në përgjigjen e tij ka njoftuar Komisionerin se nëpunësi në fjalë, ka nisur tre procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me palë të paditur DAP-in dhe Kryeministrinë (për çështjen e parë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka dalë me Vendimin nr. 4327 datë 31.12.2020, ndaj të cilit të gjitha palët kanë ushtruar ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë).

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në

nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 670 prot., datë 28.08.2020, në lidhje me lirimimin nga detyra dhe kalimin në listën e pritjes pa pagesë të anëtarëve të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues të nëpunësit ***** , dhe arkivimin e çështjes, pasi rasti është duke u shqyrtuar nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim Kryeministria, DAP dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha